

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEK-19-6984-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Shërbimet për përgatitjen e dokumentacionit për ndërtimin e brezit të gjelbërt në TCA**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH "INFRATEK"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bedri Shala 38C

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

00383 38 606 808

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Veton JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@infratek.eu

(Adresa elektronike)

07.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe yula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 16.09.2019
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 07.10.2019 13:00
Fillimi i procesit për Hapjen e Tenderit: 07.10.2019 13:00
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 28.01.2020
Kërkesa për rishqyrtim me dt: 03.02.2020
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt: 04.02.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

Dosja është dorëzuar me ane të platformës elektronike të prokurimit, gjithashtu procesverbalin e kemi pranuar me ane të kesaj platforme.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet



A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Gjene te bashkangjitur kerkesen per rishqyrtim si dhe pergjigjen e AK lidhur me kerkesen tone.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja me dt. 28.01.2020 na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar, me arsyetimin se ne si operator ekonomik nuk i plotësojmë kriteret e përcaktuara në njoftimin për

kontratë dhe dosjen e tenderit, përkatësisht në nenin 5.2 Kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), ku kërkohet “Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës 21 ditë pas nënshkrimit të kontratës”, në ofertën e juaj keni deklaruar se afati i realizimit të kontratës është 40 ditë, ndërsa kanë rekomanduar për kontratë OE “Studio Hapësira”.

Ju sqarojmë se ne jemi eliminuar kundërligjshëm për kohën e realizimit të projektit. Referuar përshkrimit në Paramasë pozicioni nr.2 citojmë: Shpimi, mostrimi dhe analizimi fiziko/kimik, përmbajtjes së metaleve të rënda dhe kontaminimi me materie organike i tokës ku do të realizohet projekti, nga kjo rrjedhë periudha minimale për mobilizimin, shpimin, marrjen e mostrave si dhe trajtimin e tyre në laboratorët e licencuar është 21 ditë deri në kompletimin e Elaboratit. Sa për informacion për ta realizuar projektin sipas normave dhe standardeve në fuqi duhet që pas këtyre rezultateve të filloj faza tjetër për Hartimin e projektit sipas pozicioneve në paramasë që rezulton me kohën e planifikuar nga ana e kompanisë tonë prej 40 ditë.

Prandaj planifikimi i AK-së për kohën e realizimit është rrjedhë teknike sepse projektet që realizohen sipas normave dhe standardeve janë të ndërlidhura me fazat e projektit të cilat e kanë kohën e implementimit.

Gjithashtu ju sqarojmë se në këtë rast AK-ja është dashur të zbatohet dispozitat e nenit 59.4 pika (i) dhe (ii), sepse afati i realizimit të kontratës i shënuar 40 ditë në ofertën tonë, duhet të konsiderohet devijim i vogël sepse nuk shkakton asnjë ndryshim material ose devijim nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Po ashtu ju sqarojmë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, sepse tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku është kërkuar dëshmi për gjeodet, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar gjeodeten z. Miranda Zeka me të cilën nuk ka marrëveshje bashkëpunimi fare, ndërsa e njëjta punon tek një kompani tjetër Taulanti SH.P.K. në shtetin e Shqipërisë. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë dhe duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse vërtetimin e ATK-së e ka të skaduar sepse e ka ofruar vërtetimin e dt.11.06.2019 (siç dihet ky vërtetim ka vlefshmeri 90 dite), ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt.07.10.2019, dhe ky vërtetim nuk tregon gjendjen e tremujorit të fundit para hapjes së ofertave, prandaj operatori i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar edhe deklaratën e TVSH-së duke mos plotësuar kërkesën e AK-së që të ofrohet certifikata e TVSH-së, prandaj ky OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju sqarojmë se ne si operator ekonomik jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit sepse edhe pse jemi OE më i lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe tek njoftimit për kontratë jemi shpallur si tenderues i eliminuar, edhe pse është dashur të shpallemi si tenderues i suksesshëm.

Ne me dt. 04.02.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Në lidhje me vërtetimin e ATK-së, AK-ja është arsyetuar duke thënë se pretendimi ynë ankimor është i papranueshëm sepse dokumenti i ATK-së kërkohet para njoftimit për dhënie të kontratës e që në momentin e kërkuar nga bartësi i lëndës OE i rekomanduar e ka sjellur dhe është në rregull. Mirëpo ne ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë fillimisht kur e ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së nuk ka qenë konform kërkesës së AK-së, (jashtë periudhës tremujore), prandaj është i papërgjegjshëm.

Në lidhje me përgjigjen që kemi marrë për pretendimin tonë ankimor në lidhje me gjeodeten ju sqarojmë se kërkesa në nenin 9.1&9.2 të FDT-së tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka qenë si në vijim: Operatori ekonomik duhet të prezantojë 1 (një) gjeodet ose gjeodet të diplomuar me tri vite përvojë në shërbime të ngjashme, prandaj në momentin që kërkohet gjeodeti atëherë operatori ekonomik duhet të dëshmojë me fakte, dëshmi konkrete siç janë kontrata apo marrëveshja e bashkëpunimit se gjeodetin në fjalë është punëtor i asaj kompanie.

Autoriteti kontraktues në përgjigjen e tyre në kërkesën tonë për rishqyrtim, nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore në lidhje me certifikatën e TVSH-së të cilën OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dorëzuar fare dhe në pretendimin tjetër ku ne jemi si ofertues me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, prandaj rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP-së.

Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë.


Po ashtu AK-ja ka vepruar në kundërshtim konform nenit 6 ku thuhet se *“Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE NTSH “INFRATEK”-Prishtinë
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në



RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

